

BASHKIA KRUJË **NJOFTIM PËR PUBLIKIM**

Bashkia Krujë, shpall fillimin e procedurave për dhënien me qira te pasuris se paluajtshme qe i perket ekonomise pyjore Kraste-Kruje. në ngastren nr.77/b , per siperfaqen totale prej 4 ha me afat perdorimi (qeraje), 10 (dhjete) vite nga data e nenshkrimit te kontratës me subjektin e perzgjedhur fitues ne bazë te procedurave të konkurimit publik sipas kushteve dhe kriterëve të njoftimit të mëposhtëm,

Bashkia Krujë Njofton

1. Fillimi i procedurave Për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste-Kruje. në ngastren nr.77/b , per siperfaqen totale prej 4 ha, pronë e bashkisë Krujë me afat perdorimi 10 vjeçar.
2. Qellimi i perdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore të përcaktuar në pikën 1, për mbareshtimin e flores se eger dhe rehabilitimin e bimesise
3. Çmimi dysHEME i fillimit të konkurrimit është 80.000 lekë ne vit, e përllogaritur kjo sipas VKM-se nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.10.2010,
4. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vite.

5. Pikët vlerësuese do të jenë :

Nr	Lloji i Kriterit	Pesha e matur ne pike e kriterit vleresues(e shprehur ne pike)
1	projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4	nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	masën e qirasë për ha/vit	35

6)-Terheqja e dokumentacionit te nevojshem do te behet ne Dretjorine e Aseteve dhe Pronave te Paluajtshme, prane Bashkise Kruje.

7)-Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit, telefon, email dhe faks
- k) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- l) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- m) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
- n) licencë QKL

8) Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë Bashkisë Krujë, Zyra e Njesisë së Prokurimeve Publike, me datë 16.04.2018, ora 10-00.

